

Turizmi

1. Turizmi në Shqipëri

Pasi ka dalë nga kronika e zezë e mediave europiane dhe stereotipet negative janë bërë pjesë e së kaluarës, Shqipëria është shndërruar në të panjohurën e Europës ose thënë ndryshe, në sekretin e fundit të saj. Vera e vitit 2008 u mbyll me një bilanc pozitiv për sa i përket turizmit dhe me diferencë të konsiderueshme nga vitet paraardhëse. Destinacionet turistike shqiptare më të preferuara vazhdojnë të jenë destinacionet e detit dhe të natyrës, por dhe ato të turizmit kulturor ku qytetet më të frekuentuara janë Kruja me kalanë dhe tregun e artikujve artizanale, pastaj Berati dhe Gjirokastra që janë shpallur pasuri kulturore botërore nga UNESCO (World Cultural Heritage), Butrinti dhe Apollonia. Shkodra dhe rajoni i saj janë gjithashtu një nga zonat me rritje të shpejtë të numrit të turistëve.

Sipas të dhënave zyrtare, në periudhën Qershor -Gusht 2008 Shqipëria është vizituar nga një milion e gjysëm persona nga të cilët 942 mijë janë me kombësi shqiptare. Kjo shifër përbën një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e tjera. Gjatë të gjithë vitit 2007, Shqipëria u vizitua nga rreth 1,100,000 vizitorë. Një risi tjetër të këtij viti e përbën fakti që të shumtë kanë qenë edhe pushuesit serbë dhe sidomos pushuesit sllavë nga Maqedonia. Arsyet kryesore të kësaj rritjeje të numrit të turistëve që vizitojnë Shqipërinë janë përmirësimi i ndjeshëm i infrastruktures dhe çmimet mjaft konkurruese në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Kosova dhe Maqedonia vazhdojnë të jenë vendet me prurjet më të larta të turistëve në Shqipëri, të ndjekura nga Greqia dhe Italia dhe më pas vendet e tjera të rajonit dhe të BE-së. Edhe promovimi ka ndikuar në rritjen e numrit të turistëve megjithëse mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim sepse vazhdon të jetë e vështirë të gjenden materiale informative për destinacionet e aq më pak për shërbimet në Shqipëri.

Sipas vlerësimeve të Organizatës Botërore të Turizmit, turizmi në Shqipëri është i destinuar të zhvillohet me shpejtësi falë potencialeve të larta turistike që zotëron vendi.

2. Adriatiku Lindor si rajon turistik

Turizmi në Adriatikon Lindor është i lidhur me ish republikat Jugosllave të bregdetit të Adriatikut dhe Shqipërinë. Në fillim të viteve 60-të të shekullit të kaluar Jugosllavia ishte ndër destinacionet më të rëndësishme për turistët e Europës Perëndimore që zgjidhnin turizmin e rërës dhe të detit. Në vitet 60-70-të pjesa më e madhe e zhvillimit të turizmit në ish Jugosllavi ishte përqëndruar gjatë bregdetit të Adriatikut. Gjatë viteve 80-të, bregdeti kroat ishte një ndër top destinacionet për europianët, në të njëjtin nivel me destinacionet e detit dhe rërës të Spanjës dhe Greqisë. Destinacionet më të preferuara në ish Jugosllavi në këtë kohë ishin Dubrovniku në Kroaci dhe Budva e Kotori në Malin e Zi. Para luftërave në Ballkan që filluan në 1991, ato ishin të lidhura ngushtë me njëra tjetrën si një destinacion i vetëm me frekuentim mjaft të lartë.

Luftërat ballkanike të viteve 90-të dëmtuan ndjeshëm turizmin në rajon. Pasojat e luftës sollën një lloj ndarjeje me natyrë politike duke e copëzuar edhe më tej Adriatikun Lindor në bregdetin kroat, malazez dhe atë shqiptar. Megjithatë, kjo lloj ndarjeje nuk sjell vetëm pasoja negative për turizmin në rajon. Ekzistenca e disa shteteve përbën në vetvete një atraksion turistik. Fakti që këto destinacione turistike janë afër me njëra tjetrën por në shtete të ndryshme perceptohet nga vizitorët si ofertë më e pasur. Rajoni i Shkodrës ka përfituar vitet e fundit nga afërsia gjeografike me rajonet turistike të Malit të Zi dhe Kroacisë duke u përfshirë në paketat turistike të këtij rajoni. Perspektiva e liberalizimit të plotë të vizave në rajon, promovimi dhe bashkëpunimi mes agjensive turistike përbën një potencial të madh për zhvillimin e turizmit në Shqipëri në përgjithësi dhe në Shkodër në veçanti. Duke u lidhur me rajonin, Shkodra do të bëhej një atraksion i përfshirë në paketat që i ofrohen turistëve të pasur nga Europa.

3. Turizmi në Rajonin e Shkodrës

3.1. Potencialet turistike të Rajonit

Rajoni i Shkodrës zotëron potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e disa llojeve të turizmit duke përfshirë turizmin detar, liqenor, malor e kulturor .

Rajoni i Shkodrës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Qyteti i Shkodrës si qendër e rajonit është i vendosur kryesisht në rrafshinë. Në drejtimin jugperëndim-verilindje ka kuotat nga 9.5 m deri në 24 m mbi nivelin e detit. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës. Nga ana lindore qyteti kufizohet nga Lumi i Kirit që buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore. Nga liqeni buron Lumi i Bunës që derdhet në detin Adriatik dhe ka një gjatësi prej 44 km. Rrjedha e poshtme e lumit Buna ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi i Bunës bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit. Shkodra nga ana lindore dhe jugore rrethohet nga një varg kodrash deri në 110 m lartësi. Në jugperëndim gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës, pikë strategjike shekullore, me lartësi 130 m dhe sipërfaqe 3.6 ha. Nga veriu dhe veriperëndimi shtrihet Fusha e Mbi-Shkodrës, përtej të cilës fillojnë Alpet e Shqipërisë. Rreth 30 km në juglindje ndodhet bregdeti adriatik me Plazhin e Velipojës. Brenda një rrezeje prej 30 km, me qendër Qytetin e Shkodrës, janë të përfshira disa lloje zonash gjeografike me relieve të ndryshme që shtrihen nga Alpet deri në bregdet, duke përfshirë liqenin e Shkodrës (më i madhi në Ballkan), disa lumenj dhe disa masive malore me potenciale të mëdha për turizëm. Klima e rajonit ka përgjithësisht tipare mesdhetare në bregdet dhe në zonat e ulëta dhe tipare kontinentale në zonat malore.

3.2. Aksesit drejt Rajonit të Shkodrës

Infrastruktura dhe aksesit drejt rajonit të Shkodrës janë përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Kjo ka bërë që udhëtimi të bëhet më komod dhe më i shpejtë.

Në rrugë ajrore, Shkodra mund të arrihet nga aeroporti i Rinasit "Nënë Tereza", (80 km, 75 minuta) dhe ai i Podgoricës, Mali i Zi, (55 km, 60 minuta, duke kaluar nga Hani i Hotit).

Nëpërmjet detit mund të ndiqen itineraret e mëposhtme:

Nga porti i Tivarit, Mali i Zi (60 km, 80 minuta duke kaluar nga pika e kalimit kufitar të Muriqanit), nga porti i Durrësit (123 km, 90 minuta) dhe nga porti i Vlorës (233 km, 3 orë).

Në rrugë tokësore:

Nga Mali i Zi në itineraret Hani i Hotit-Shkodër (35 km), Muriqan-Shkodër (15 km).

Nga Kosova në itineraret Morinë-Kukës-Shkodër (176 km), Qafa e Prushit-Kukës-Shkodër (188 km).

Nga Maqedonia në itineraret Bllatë-Peshkopi- Milot-Shkodër (199 km), Qafë Thanë-Tiranë-Shkodër (218 km).

Nga Greqia në itineraret Kapshticë-Tiranë-Shkodër (280 km), Kakavijë-Tiranë-Shkodër (320 km).

3.3. Tendencat e zhvillimit të turizmit në Shkodër

Vitet e fundit, edhe qarku i Shkodrës ka ndjekur trendin pozitiv që ka pasur Shqipëria për sa i përket numrit të vizitorëve. Statistikat zyrtare për numrin e vizitorëve që kalojnë në pikat kufitare të rajonit të Shkodrës tregojnë për një rritje pak a shumë konstante prej 30% në vit për 4 vitet e fundit. Një pjesë të mirë të këtyre vizitave orëve e zënë turistë që vizitojnë Shkodrën si pjesë e paketave turistike të Kroacisë dhe Malit të Zi. Në pjesën më të madhe janë vizitorë nga Europa Perëndimore por vihet re një prani gjithnjë e më e madhe e vizitorëve edhe nga Europa Lindore e nga vende të tjera. Ata kryesisht vizitojnë Shkodrën për një ditë dhe kthehen përsëri në drejtim të Malit të Zi. Vetëm një pjesë e vogël e tyre vazhdojnë udhëtimin në qytete ose destinacione të tjera shqiptare. Zgjatja e kohëqëndrimit të tyre në Shkodër, është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilën përballlet sot turizmi në rajon.

Ka një tendencë rritjeje të numrit të vizitorëve që vijnë në Shkodër me ture të vetëorganizuar (me motorë, biçikleta, campers etj). Koha e qëndrimit të tyre është më e gjatë, për vetë natyrën e organizimit dhe të udhëtimit të tyre, por përmirësimi i informacionit, i promovimit dhe i shërbimeve për to do të rriste me siguri kohën e qëndrimit.

Një kontingjent shumë të rëndësishëm të vizitorëve në Shkodër e përbëjnë pushuesit shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia dhe ata të emigruar kryesisht në Europë. Ata preferojnë turizmin e rërës dhe detit pra zgjedhin të pushojnë në plazhin e Velipojës. Pushimet e tyre zakonisht zgjasin nga 1 deri në 2 javë dhe janë të përqëndruara kryesisht në periudhën 15 Korrik-15 Gusht. Këtë vit, ndryshe nga vitet e tjera, numri i tyre ka qenë më i madh dhe më i shtrirë në kohë. Pushimet organizohen gati gjithmonë nga agjensi udhëtimi të Kosovës dhe Maqedonisë të cilat kujdesen për gjithçka. Tendencat e fundit është rritja e numrit të vizitorëve shqiptarë të Kosovës dhe Maqedonisë që vizitojnë Shkodrën në mënyrë të organizuar (kryesisht nxënës të shkollave). Ata janë të orientuar kryesisht drejt turizmit kulturor dhe didaktik dhe këto vizita iu shërbejnë kryesisht për ilustrimin e lëndëve të historisë dhe gjeografisë.

3.4. Atraksione të spikatura turistike të rajonit

Kalaja e Shkodrës.

Kalaja e Shkodrës ndodhet në hyrjen jugore të qytetit, në një pozicion strategjik, rrethuar nga lumenjtë Buna, Drini dhe Kiri. Muret rrethuese janë 880 m të gjatë dhe rrethojnë një sipërfaqe prej 35 000 m². Është kalaja më e madhe në Shqipëri dhe ndër më të mëdhatë në Ballkan.

Në këtë kala 2400-vjeçare takojmë gjurmët e periudhës klasike, të mesjetës e deri të shekullit të kaluar. Në fortifikimet dhe objektet e tjera ndërtimore ruhen edhe sot gjurmë antike, mesjetare e deri në ato të periudhës së Bushatllinjve. Në objektet e vizitueshme përveç sistemit fortifikues mund të përmenden kisha e Shën Stefanit e kthyer më pas në xhami, kapiteneria, burgu, saranxhat dhe daljet sekrete. Nga muret e saj mund të soditen pamjet madhëshore e piktoreske të qytetit, të liqenit të Shkodrës dhe lumenjve të Drinit, Bunës dhe Kirit.

Muzeu Historik

Muzeu Historik i Shkodrës gjendet në një banesë karakteristike shkodrane të shekullit të XVIII që quhet shtëpia e Oso Kukës. Muzeu është i ndarë në tre sektorë, sektorin e Arkeologjisë, të Historisë dhe të Etnografisë.

Fondi arkeologjik i Muzeut përmban rreth 500 objekte që përfaqësojnë të gjitha periudhat historike, nga Neoliti (6000 vjet p.e.s.) deri në Mesjetën e vonë (shek.XVI). Sektori i Historisë përmban arkivin dokumentar dhe relikte të karakterit historik. Pjesë e Arkivit është edhe filmoteka me mbi 3000 materiale të filmuara si dhe fonoteka. Në këtë Muze ruhet dhe një koleksion me objekte të artit të pikturës e skulpturës (105 punime). Fondi i objekteve historike të Muzeut përbëhet nga 4 koleksione kryesore që dokumentojnë periudhën nga shek. XV deri më sot, koleksioni i armëve, koleksioni i relikteve, koleksioni i vulave dhe koleksioni numizmatik. Sektori i Etnografisë ka një fond prej rreth 1500 objektesh që u përkasin shek.XVIII - XX. Ato janë prodhime artizanale të qytetit të Shkodrës e zonave gjeo-etnografike të pellgut të tij, Dukagjinit, M.Madhe, Shllakut, Postribës, Zadrimës, Anamalit, Krajës si dhe të krahinave të Pukës e të Mirditës.

Fototeka "Marubbi"

Është një ndër vlerat më të paçmueshme që mban sot rajoni i Shkodrës për sa i përket trashëgimisë kulturore. Fototeka ka një fond prej ga ti 400 000 negativësh nga fotografia e parë (Hamza Kazazi, 1858) dhe deri në vitet 70-të të shekullit të kaluar. Rreth gjysma e fondit që është edhe pjesa më e rëndësishme dhe me vlerë përbëhet nga fondi i familjes Marubbi duke filluar nga Pietro Marubbi (1834 - 1903) me origjinë nga Piacenca (Itali) i ardhur si azilant politik në Shkodër, Kel Marubbi (1870 - 1940) dhe brezi i tretë, djali i Kelit, Gegë Marubi.

Pjesa tjetër e fondit që përbën edhe gati gjysmën e tij përbëhet nga fondet e familjeve të fotografëve Pici, Rraboshta, Jakova e Nenshati. Vlen të theksohet se secili prej këtyre fotografëve kishte krijuar profilin e vet të fotografit artist.

Fototeka "Marubi" ruan përveç negativëve edhe regjistrat origjinalë, që nga viti 1918, ku janë të regjistruar me saktësi emrat e personave e grup-personave si dhe datat e sakta të fotografimit. Me vlera të veçanta muzeale janë edhe objektet e materialet e përdorura nga familja Marubbi dhe fotografët e tjerë në studiot e tyre.

Liqeni i Shkodrës

Ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë dhe është pjesë e kufirit të Shqipërisë me Malin e Zi. Me një lartësi mesatare 4.5 m mbi nivelin e detit ai është liqeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit me një sipërfaqe prej 368 km² nga të cilat 149 km² përfshihen brenda territorit të Shqipërisë dhe pjesa tjetër në Malin e Zi. Liqeni i Shkodrës përfaqëson rrjetin më të madh të ujrave të ëmbla në Mesdhe. Liqeni ka florë dhe faunë mjaft të pasur ku gjenden rreth 65 lloje peshku, 240 lloje shpendësh

dhe mbi 800 lloje bimësh. Liqeni është një burim vlerash klimaterike. Klima e tij është mjaft e shëndetshme. Liqeni i Shkodrës dhe zona përreth kanë një potencial mjaft të lartë për zhvillimin e turizmit.

Plazhi i Velipojës

Zona e Velipojës ndodhet buzë detit Adriatik, 36 km nga qyteti i Shkodrës (rreth 30 minuta me makinë nga qyteti). Është një nga perlat e natyrës shqiptare, ku gërshetohen harmonishëm deti, lumi, mali, ishulli, laguna dhe pylli duke krijuar potenciale të shumta për zhvillimin e një game të gjerë të aktiviteteve turistike. Plazhi i Velipojës ka gjatësi prej 14 km dhe gjerësi mesatare 150 m. Shtrihet nga delta e Bunës deri në rrëzë të malit Maja e Zezë. Plazhi ka rërë të imët të bollshme që ripërtërihet dhe pastrohet nga valët e detit dhe ka një % të lartë të jodit duke mbartur kështu vlera të larta kurative.

Thethi

Thethi është i vetmi park kombëtar në rajonin e Shkodrës dhe parku i dytë për nga madhësia në Shqipëri pas parkut kombëtar të Dajtit, me një sipërfaqe prej 2630 ha. Thethi ndodhet në pjesën veriore të komunës së Shalës në lartësinë nga 740-950 mbi nivelin e detit dhe rrethohet nga malet e Alpeve shqiptare me lartësi deri në 2559.4 m. Në Theth gjenden 70 burime uji me një cilësi dhe pastërti për t'u admiruar. Flora dhe fauna e zonës janë mjaft të pasura (1100 lloje bimësh që përbëjnë 1/3 e llojeve të bimëve të vendit). Klima është mesdhetare malore me dimër të ftohtë me dëborë dhe verë të freskët. Thethi është interesant edhe për atraksionet e tij kulturore ku një vend të veçantë zë në Kullat e Ngujimit, karakteristike për zonat e malësive të veriut si dhe veshjet e zonës. Thethi gjendet rreth 65 km nga qyteti i Shkodrës dhe arrihet pas një udhëtimi prej 2 orësh .

3.5. Atraksione të veçanta turistike

Shkodra dhe rajoni i saj janë një zonë që ofron disa lloje të veçanta atraksionesh turistike të cilat janë unike për vendin dhe më gjerë.

Së pari, një atraksion mjaft i veçantë është tregu i punimeve artizanale karakteristike të zonës. Kjo traditë historike e punimeve (të grave) vazhdon të ruhet e të kultivohet dhe sot me punime të dorës të sixhadeve, qilimave, veshjeve e zbukurimeve. Këto produkte po promovohen së fundmi përmes Panairit të Artizanatit që organizohet çdo vit në qytet. Përmes mbështetjes së organizatave të ndryshme, ky treg është duke u zhvilluar dhe është i arritshëm për turistët që vizitojnë qytetin.

Një tjetër veçanti unike e rajonit është bashkëjetesa e mrekullueshme mes komuniteteve fetare. Është ndoshta unike, ose së paku mjaft e rrallë në botë, mundësia për të fotografuar në një fotografi të vetme një xhami, një kishë katolike dhe një kishë ortodokse (në qendër të qytetit në distancë jo më larg se 100 m nga njëra tjetra). Në përgjithësi, oportunitetet për turizëm kulturor dhe ekologjik janë mjaft të veçanta.

3.6. Superstruktura turistike e rajonit

Hotelet në qytetin e Shkodrës ofrojnë mundësi akomodimi mjaft të diversifikuara. Hotelet që ofrojnë kushte të mira kanë çmime që variojnë nga 30 -60 Euro.

Përgjithësisht, të tjerët që ofrojnë kushte minimale për akomodim kanë një çmim prej 10-20 Euro. Kohët e fundit hotelet kryesore të qytetit janë renditur edhe në website-t e rezervimit dhe të agjensive turistike. Hotelet kryesore ofrojnë të gjitha facilitetet moderne të tilla si restorante me kuzhinë tradicionale dhe italiane, bare, salla konferencash, fitness, sauna, pishinë verore, internet, etj. Gjithashtu në qytet funksionon edhe akomodimi në hotele të vogla dhe akomodimi familjar. Kapaciteti hotelerrik i hoteleve të regjistruara është gjithësi ende i vogël, rreth 300 shtreter.

Superstruktura turistike në zonën e Velipojës është e organizuar kryesisht për pushime familjare me kosto të lirë. Kapaciteti hotelerrik është i lartë, rreth 15,000 shtretër. Megjithatë, superstruktura e turizmit është përgjithësisht në një fazë të hershme të zhvillimit dhe nuk ofron kushte të diversifikuara për shtresa të ndryshme turistësh.

Në zonat e tjera dhe sidomos në zonat malore po vihet re një shtim i konsiderueshëm i numrit të shtëpive-bujtina të cilat ofrojnë mundësi akomodimi për pushues-vizitorë të interesuar për të vizituar Alpet Shqiptare. Ekzistenca e tyre është shumë e rëndësishme pasi përbëjnë të vetmen mundësi akomodimi për turistët. Zakonisht këto bujtina ofrojnë fjetjen dhe ushqimin (kryesisht tradicional të zonës) për çmime që variojnë 10-30 euro nata.

Restorantet janë relativisht të shumtë (kryesisht në Shkodër, në Velipojë dhe në zonën rreth liqenit) dhe po ashtu janë edhe mundësitë për të zgjedhur. Kuzhina e ofruar është tradicionale dhe mesdhetare ku mbizotëron në këtë të fundit kuzhina italiane. Çmimet janë mjaft konkurruese, një vakt normal varion në shifrat 10-15 Euro. Restorante të një cilësie shumë të mirë mund të gjenden në Shkodër, në Velipojë, në zonen rreth liqenit, në brigjet e Drinit dhe Bunës dhe gjithashtu edhe në vende të tjera me atraksione turistike.

Transporti për qëllime turizmi është ende i pazhvilluar dhe ofrohet kryesisht me ture të organizuara nga agjensitë turistike. Në Shkodër funksionojnë më tepër se 10 agjensi turistike të cilat ofrojnë vizita, ture dhe paketa turistike. Megjithatë, promocioni dhe vizibiliteti i tyre (psh në internet) mbetet ende i limituar.

10 arsye për të vizituar Shkodrën!

1. Për larminë e atraksioneve turistike
2. Për larminë e peisazheve
3. Për çmimet konkurruese
4. Për larminë e aktiviteteve që mund të zhvillohen
5. Për historinë
6. Për mikpritjen
7. Për kuzhinën
8. Për muzikën
9. Për pozitën gjeografike
10. Për të vizituar qendrën historikisht më të rëndësishme të Veriut të Shqipërisë.